



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1065/Prot.  
2

Tiranë, më 10 /01/2024

VENDIM

Nr. 2, DATË 10 /01/2024

MBI

“MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E UNIVERSITETIT TË ARTEVE”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 3, pika 2, gërma (c) (Liria akademike dhe autonomia e institucioneve të arsimit të lartë), neni 33, pika 2 (Statuti dhe rregullorja e institucioneve të arsimit të lartë), neni 38 (Funksionet e Senatit Akademik), të Statutit të Universitetit të Arteve, neni 24 (Funksionet e Senatit Akademik), neni 148 (Procedura e ndryshimit të Statutit) si dhe në vendimin e Bordit të Administrimit nr. 24, dt. 04.12.2023, “Mbi miratimin paraprak të disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Arteve”, pas shqyrtimit dhe diskutimeve, Senati Akademik i UART,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kriterëve për fitimin e titujve akademikë ekuivalent: “Profesor i Asociuar në Arte” me titullin “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor në Arte” me titullin “Profesor”, të parashikuara në pikat 2 (dy) deri në 10 (dhjetë) të nenit 67 të vendimit të Bordit të Administrimit nr. 24, dt. 04.12.2023, “Mbi miratimin paraprak të disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Arteve”. Kriteret për fitimin e titujve ekuivalent do të propozohen nga Dekanatet e Fakulteteve në UART për secilin program studimi që ato ofrojnë dhe do të miratohen nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve, si pjesë përbërëse e rregullores së Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik.
2. Rrëzimin e pikës 8 (tetë), të nenit 33 të vendimit të Bordit të Administrimit nr. 24, dt. 04.12.2023, “Mbi miratimin paraprak të disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Arteve”.
3. Miratimin e ndryshimeve në Statutin e Universitetin e Arteve.

Ndryshimet do të paraqiten me gërma italike dhe do të jenë të nënvizuara, si më poshtë vijon:

**Neni 13, pika 6, gërma k,** shtohet një togfjalësh pas “Profesor i asociuar”:

“k) Vlerëson, miraton ose jo dosjet e kandidatëve për fitimin e titullit akademik “Profesor” ose “Profesor i asociuar” si dhe titujt akademikë ekuivalent me to. Dosjet që plotësojnë kriteret ja përcjell Komisionit të Përhershëm për Titujt Akademikë, në përputhje me rregullat e posaçme të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rregulloren e funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Titujt Akademikë.”

**Neni 22,** shtohet pika 6.1., me këtë përmbajtje:

“6.1. Anëtarët e KIZ-it, të KZF dhe të Komisionit të Apelit, të cilët përfshihen në procesin e organizimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, shpërblehen për punën që bëjnë në masën e një page mujore për vitin që angazhohen në zgjedhje. Shpërblimi miratohet me vendim të Bordit të Administrimit të UART”.

**Neni 24, pika 1, gërma u,** fjala “i Përhershëm” zëvendësohet me “Ad Hoc”:

“u) Ngre Komisionin Ad Hoc për ekuivalentimin e kualifikimit për personelin akademik krijues dhe interpretues me punën kërkimore–shkencore në zbatim të VKM-së nr. 145, datë 10.03.2021, për promovimin e personelit akademik me gradë shkencore.”

**Neni 27,** pika 1, gërma f, shtohet një togfjalësh:

“f) Nënshkruan titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” si dhe titujt akademikë ekuivalent me to, pas miratimit të tyre.”

**Neni 30,** pika 3 riformulohet dhe në pikën c bëhen këto ndryshime:

“Senati Akademik ngre komisionet e përhershme si më poshtë:

- a) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik.
- b) Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.
- c) Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët.”

**Neni 31,** pikës 1 i shtohet një togfjalësh pas “Profesor i asociuar” si dhe shtohet pika 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“1. Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, është struktura përgjegjëse për dhënien e titujve “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” si dhe titujt akademikë ekuivalent me to në Universitetin e Arteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

“7. Komisioni për vlerësimin e dhënies së titujve akademikë në Universitetin e Arteve, ka kompetencë të plotë në verifikimin e dokumentacionit të depozituar prej secilit aplikant, duke u mbështetur në kriteret përkatëse dhe mban përgjegjësi për çdo vlerësim të tyre.”

“8. Rregullime të tjera mbi procedurën për dhënien e titujve akademikë parashikohen në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Komisionit Për Promovimin e Personelit Akademik.”

**Neni 33**, fjala “i Përhershëm” në titull si dhe në pikën 1 zëvendësohet me “Ad Hoc” dhe shtohet pika 7 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 33

Komisioni *Ad Hoc* për Ekuivalentimin e gradës shkencore për Personelin Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”

1. Komisioni *Ad Hoc* për ekuivalentimin e gradës shkencore për Personelin Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, ngrihet me vendim të posaçëm të Senatit Akademik të UART.

7. Anëtarët e Komisionit Ad Hoc për Ekuivalentimin e gradës shkencore për personelin akademik me kohë të plotë dhe atë të ftuar shpërblehen financiarisht për punën e kryer në masën e një page mujore në vit sipas kategorisë. Shpërblimi miratohet nga Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve.

**Neni 34**, bëhen këto ndryshime, para togfjalëshit “Marrëdhënieve me Studentët” në titull si dhe në pikën 1, shtohet togfjalëshi “Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe”:

“Neni 34

Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët”

“1. Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët ngrihet për të garantuar dhe për të zhvilluar marrëdhëniet e bashkëpunimit midisorganeve drejtuese të Universitetit të Arteve dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 3 janë anëtarë pjesë e personelit akademik dhe 3 anëtarë përfaqësues të studentëve dhe 1 specialisti i kurrikulës dhe informimit të studentëve. Anëtarët përfaqësues të studentëve dhe anëtarët përfaqësues të personelit akademik vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.”

**Neni 55**, pas pikës 3 shtohen pikat 3.1., 3.2. dhe 3.3. me këtë përmbajtje, ndërsa pikat e tjera të këtij neni mbetet me të njejtën renditje dhe të pandryshuara:

“3.1. Në Universitetin e Arteve, si institucion i arsimit të lartë me status të veçantë me veprimtari në fushën e arteve, në zbatim të legjislacionit në fuqi jepen edhe titujt akademikë “Profesor në Arte” dhe “Profesor i Asociuar në Arte”.

3.2. Anëtarët e personelit akademik që kanë fituar titullin akademik “Profesor në Arte”, ekuivalent me “Profesor”, dhe “Profesor i Asociuar në Arte”, ekuivalent me “Profesor i Asociuar”, do të gëzojnë të njejtat të drejta si mbajtësit e titujve “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar” vetëm për efekt të mësimdhënies dhe atë financiar, pa gëzuar të drejtën e të zgjedhurit apo emëruarit në pozicione që kërkojnë personel akademik nga kategoria “Profesor”, apo të caktimit si udhëheqës shkencor.

3.3. Titujt akademikë “Profesor në Arte” dhe “Profesor i Asociuar në Arte” kanë vlefshmëri vetëm dhe për sa kohë mbajtësit e këtyre titujve janë personel akademik me kohë të plotë pranë Universitetit të Arteve.”

**Neni 58**, pika 4, pas fjalës “Komisioni”, bëhet zëvendësimi i fjalës “i Përhershëm” me “Ad Hoc”:

“4. Për personelin akademik të ftuar, të vlerësuar nga Komisioni *Ad Hoc* për Ekuivalentimin e Personelit Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë” dhe të miratuar nga Senati Akademik, rektori i UART lidh kontratën e punës.”

**Neni 59**, pika 1, pas fjalës “Profesor” shtohet togfjalëshi “apo titullin ekuivalent “Profesor në Arte” dhe pas togfjalëshit “Profesor i Asociuar”, shtohet tografjalëshi “apo titullin ekuivalent “Profesor i Asociuar në Arte”:

“1. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor” apo titullin ekuivalent “Profesor në Arte” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, ndërsa personeli akademik që mban titullin “Profesor i asociuar” apo titullin ekuivalent “Profesor i Asociuar në Arte” shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Personeli akademik i kategorisë lektor qëndron në detyrë deri në moshën e pensionit në përputhje me legjislacionin përkatës. Në të gjitha rastet, ndërprerja e detyrës bëhet jo më përpara se përfundimi i vitit akademik.”

**Neni 63**, pika 9, në fund të paragrafit shtohet një fjali si dhe pika 15, pas fjalës “Profesor”, shtohet një togfjalësh:

“9. Organizimi i punës artistike-kërkimore-shkencore realizohet në përputhje me planifikimin që secili departament bën në fillim të vitit akademik. Puna artistike-kërkimore-shkencore realizohet nga të gjitha kategoritë e personelit akademik në përputhje me ndarjen që ka realizuar departamenti për këtë qëllim dhe drejtohet nga kategoria e personelit akademik “Profesor”. Departamenti, në organizimin e punës artistike, angazhon personel

akademik mbajtës të titujve akademikë “Profesor i Asociuar në Arte” dhe “Profesor në Arte”.

“15. Personeli akademik i kategorisë “Profesor” si dhe ekuivalent me të”Lektor” mund të gjenerojë (hartojë, aplikojë, zbatojë) projekte mësimore artistike, kërkimore nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në përputhje me objektin e veprimtarisë së njësies bazë ku bën pjesë dhe mbështetur në këtë Statut dhe gjithë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.”

**Neni 67, shtohen pikat 2 - 4, ndërsa pika 2 merr numrin 5, me këtë përmbajtje:**

“2. Aplikimi për fitimin e titullit “Profesor i asociuar në Arte”, ekuivalent me “Profesor i asociuar” dhe “Profesor në Arte”, ekuivalent me “Profesor”, nga personeli akademik me kohë të plotë pranë Univërsitetit të Arteve, bëhet në zbatim të VKM-së nr. 145, dt. 10.03.2021 “Për dhënien e Statusit të veçantë Univërsitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mbështetur në kriteret e miratuara nga Senati Akademik.

3. Personeli akademik, i cili ka titullin “Profesor i asociuar në Arte”, aplikon për fitimin e titullit “Profesor në Arte”, të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit “Profesor i asociuar në Arte”. “Profesor i Asociuar”.

4. Fitimi i titullit “Profesor i asociuar në Arte” dhe “Profesor në Arte” do të shoqërohet me efekte financiare sipas titullit akademik ekuivalent.

5. Veprimtaria e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik rregullohet përmes rregullores së tij të brendshme, e cila miratohet nga Senati Akademik, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.”

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

### **SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof. Kastriot ÇAUSHI**

**Prof. Najada HAMZAJ**

**Prof. Dr. Isak SHEHU**

**Prof. Hir MARTINI**

**Prof. Artan PEQINI**

**Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)**

**Prof. Arben LLOZI**

**Prof. Asoc. Dorian ÇENE**

**Prof. Asoc. Dr. Kastriot TUSHA**

**Prof. Endri SINA**

**Prof. Asoc. Albes FUSHA**

**Prof. Asoc. Genci FUGA**

**Sindi ZDRAVA (Studente FM)**

**Prof. Asoc. Dr. Artan IBËRSHIMI**

**Prof. Gazmend GJOKA**

**Prof. Dr. Erald BAKALLI**

**Prof. Asoc. Edmond GJIKOPULLI**

**Prof. Asoc. Zamir KOKONOZI**

**Erlind FUSHA (Student FAB)**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1065/1 Prot.

Tiranë, më 04/12/2023

VENDIM

Nr. 94, DATË 04/12/2023

MBI

“MIRATIMIN PARAPRAK TË DISA NDRYSHIMEVE NË STATUTIN E  
UNIVERSITETIT TË ARTEVE”

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 49, pika 1, gërma (gj), të Statutit të Universitetit të Arteve, neni 48, pika 1, gërma b, (*Liria akademike dhe autonomia e insitucioneve të arsimit të lartë*), neni 49 (*Funksionet e Bordit të Administrimit*), mbështetur në materialin bashkëlidhur të Rektoratit të UART me titull “Relacion shpjegues për disa ndryshime në Statutin e Universitetit të Arteve”, pas shqyrtimit dhe diskutimeve, Bordi i Administrimit të UART,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të disa ndryshimeve në Statutin e Universitetit të Arteve.

Ndryshimet do të paraqiten me gërma italiane dhe do të jenë të nënvizuara, si më poshtë vijon:

**Neni 13, pika 6, gërma k**, shtohet një togfjalësh pas “Profesor i asociuar”:

“k) Vlerëson, miraton ose jo dosjet e kandidatëve për fitimin e titullit akademik “Profesor” ose “Profesor i asociuar” si dhe titujt akademikë ekuivalent me to. Dosjet që plotësojnë kriteret ja përcjell Komisionit të Përhershëm për Titujt Akademikë, në përputhje me rregullat e posaçme të përcaktuara me akte ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rregulloren e funksionimit të Komisionit të Përhershëm për Titujt Akademikë.”

Neni 22, shtohet pika 6.1., me këtë përmbajtje:

“6.1. Anëtarët e KIZ-it, të KZF dhe të Komisionit të Apelimit, të cilët përfshihen në procesin e organizimit dhe zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit Akademik në Universitetin e Arteve, shpërblehen për punën që bëjnë në masën e një page mujore për vitin që angazhohen në zgjedhje. Shpërblimi miratohet me vendim të Bordit të Administrimit të UART”.

Neni 24, pika 1, gërma u, fjala “i Përhershëm” zëvendësohet me “Ad Hoc”:

“u) Ngre Komisionin Ad Hoc për ekuivalentimin e kualifikimit për personelin akademik krijues dhe interpretues me punën kërkimore–shkencore në zbatim të VKM-së nr. 145, datë 10.03.2021, për promovimin e personelit akademik me gradë shkencore.”

Neni 27, pika 1, gërma f, shtohet një togfjalësh:

“f) Nënshkruan titujt akademikë “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” si dhe titujt akademikë ekuivalent me to, pas miratimit të tyre.”

Neni 30, pika 3 riformulohet dhe në pikën c bëhen këto ndryshime:

“Senati Akademik ngre komisionet e përhershme si më poshtë:

- a) Komisioni i Promovimit të Personelit Akademik.
- b) Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë.
- c) Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët.”

Neni 31, pikës 1 i shtohet një togfjalësh pas “Profesor i asociuar” si dhe shtohet pika 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“1. Komisioni i Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik, është struktura përgjegjëse për dhënien e titujve “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” si dhe titujt akademikë ekuivalent me to në Universitetin e Arteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

“7. Komisioni për vlerësimin e dhënies së titujve akademikë në Universitetin e Arteve, ka kompetencë të plotë në verifikimin e dokumentacionit të depozituar prej secilit aplikant, duke u mbështetur në kriteret përkatëse dhe mban përgjegjësi për çdo vlerësim të tyre.”

“8. Rregullime të tjera mbi procedurën për dhënien e titujve akademikë parashikohen në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Komisionit Për Promovimin e Personelit Akademik.”



**Neni 33**, fjala “i Përhershëm” në titull si dhe në pikën 1 zëvendësohet me “Ad Hoc” dhe shtohen pikat 7 dhe 8 me përmbajtje si më poshtë:

“Neni 33

Komisioni *Ad Hoc* për Ekuivalentimin e gradës shkencore për Personelin Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”

1. Komisioni *Ad Hoc* për ekuivalentimin e gradës shkencore për Personelin Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, ngrihet me vendim të posaçëm të Senatit Akademik të UART.

7. Anëtarët e Komisionit Ad Hoc për Ekuivalentimin e gradës shkencore për personelin akademik me kohë të plotë dhe atë të ftuar shpërblehen financiarisht për punën e kryer në masën e një page mujore në vit sipas kategorisë. Shpërblimi miratohet nga Bordi i Administrimit i Universitetit të Arteve.

8. Ekuivalentimi i gradës shkencore për personelin akademik me kohë të plotë dhe atë të ftuar do të ketë efekt vetëm për mësimdhënien dhe nuk do të shoqërohet me efekte financiare.”

**Neni 34**, bëhen këto ndryshime, para togfjalëshit “Marrëdhënieve me Studentët” në titull si dhe në pikën 1, shtohet togfjalëshi “Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe”:

“Neni 34

Komisioni i *Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët*”

“1. Komisioni i *Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët* ngrihet për të garantuar dhe për të zhvilluar marrëdhëniet e bashkëpunimit midis organeve drejtuese të Universitetit të Arteve dhe të studentëve dhe/apo organizmave studentorë. Komisioni përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët 3 janë anëtarë pjesë e personelit akademik dhe 3 anëtarë përfaqësues të studentëve dhe 1 specialisti i kurrikulës dhe informimit të studentëve. Anëtarët përfaqësues të studentëve dhe anëtarët përfaqësues të personelit akademik vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.”

**Neni 55**, pas pikës 3 shtohen pikat 3.1., 3.2. dhe 3.3. me këtë përmbajtje, ndërsa pikat e tjera të këtij neni mbetet me të njejtën renditje dhe të pandryshuara:

“3.1. Në Universitetin e Arteve, si institucion i arsimit të lartë me status të veçantë me veprimtari në fushën e arteve, në zbatim të legjislacionit në fuqi jepen edhe titujt akademikë “Profesor në Arte” dhe “Profesor i Asociuar në Arte”.

3.2. Anëtarët e personelit akademik që kanë fituar titullin akademik “Profesor në Arte”, ekuivalent me “Profesor”, dhe “Profesor i Asociuar në Arte”, ekuivalent me “Profesor i Asociuar”, do të gëzojnë të njejtat të drejta si mbajtësit e titujve “Profesor” dhe “Profesor i Asociuar” vetëm për efekt të mësimdhënies dhe atë financiar, pa gëzuar të drejtën e të zgjedhurit apo emëruarit në pozicione që kërkojnë personel akademik nga kategoria “Profesor”, apo të caktimit si udhëheqës shkencor.

3.3. Titujt akademikë “Profesor në Arte” dhe “Profesor i Asociuar në Arte” kanë vlefshmëri vetëm dhe për sa kohë mbajtësit e këtyre titujve janë personel akademik me kohë të plotë pranë Universitetit të Arteve.”

**Neni 58**, pika 4, pas fjalës “Komisioni”, bëhet zëvendësimi i fjalës “i Përhershëm” me “Ad Hoc”:

“4. Për personelin akademik të ftuar, të vlerësuar nga Komisioni *Ad Hoc* për Ekuivalentimin e Personelit Akademik me kohë të plotë dhe atij të ftuar në zbatim të VKM-së Nr. 145, datë 10.03.2021, “Për dhënien e Statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë” dhe të miratuar nga Senati Akademik, rektori i UART lidh kontratën e punës.”

**Neni 59**, pika 1, pas fjalës “Profesor” shtohet togfjalëshi “apo titullin ekuivalent “Profesor në Arte” dhe pas togfjalëshit “Profesor i Asociuar”, shtohet tografjalëshi “apo titullin ekuivalent “Profesor i Asociuar në Arte”:

“1. Personeli akademik, që mban titullin “Profesor” apo titullin ekuivalent “Profesor në Arte” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, ndërsa personeli akademik që mban titullin “Profesor i asociuar” apo titullin ekuivalent “Profesor i Asociuar në Arte” shërben në detyrë deri në moshën 65 vjeç. Personeli akademik i kategorisë lektor qëndron në detyrë deri në moshën e pensionit në përputhje me legjislacionin përkatës. Në të gjitha rastet, ndërprerja e detyrës bëhet jo më përpara se përfundimi i vitit akademik.”

**Neni 63**, pika 9, në fund të paragrafit shtohet një fjali si dhe pika 15, pas fjalës “Profesor”, shtohet një togfjalësh:

“9. Organizimi i punës artistike-kërkimore-shkencore realizohet në përputhje me planifikimin që secili departament bën në fillim të vitit akademik. Puna artistike-kërkimore-shkencore realizohet nga të gjitha kategoritë e personelit akademik në përputhje me ndarjen që ka realizuar

departamenti për këtë qëllim dhe drejtohet nga kategoria e personelit akademik "Profesor".  
Departamenti, në organizimin e punës artistike, angazhon personel akademik mbajtës të titujve akademikë "Profesor i Asociuar në Arte" dhe "Profesor në Arte".

"15. Personeli akademik i kategorisë "Profesor" si dhe ekuivalent me të" Lektor" mund të gjenerojë (hartojë, aplikojë, zbatojë) projekte mësimore artistike, kërkimore nga burime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në përputhje me objektin e veprimtarisë së njësisë bazë ku bën pjesë dhe mbështetur në këtë Statut dhe gjithë akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi."

Neni 67, shtohen pikat 2 - 12, ndërsa pika 2 merr numrin 13, me këtë përmbajtje:

"2. Personeli akademik me kohë të plotë që aplikon për titullin "Profesor i asociuar në Arte", ekuivalent me "Profesor i Asociuar" duhet:

- a) të ketë zhvilluar një cikël të plotë leksionesh për, së paku, një lëndë, për 3 (tri) vite akademike;
- b) të ketë përvojë pune si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë, së paku, 5 (pesë-vjeçare, me apo pa ndërprerje ose me kohë të pjesshme, për një periudhë 8 (tetë-vjeçare akademike, me apo pa ndërprerje);
- c) të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle, ose të mbrojë veprimtarinë artistike përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje me statutin dhe rregulloren e UART.
3. Personeli akademik në fushën e arteve, që aplikon për fitimin e titullit akademik "Profesor i asociuar në Arte", i njëvlershëm me titullin akademik "Profesor i asociuar", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij artistike, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:
  - a) Për kompozitorët të kenë krijuar vepra të luajtura në skena që përfshijnë formën e sonatës ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë) ose vokalo sinfonike.
  - b) Për instrumentistët të kenë interpretuar vepër/a solistike në formën e sonatës ose ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë).
  - c) Për këngëtarët lirikë të kenë interpretuar në rol kryesor në opera;
  - d) Për dirigjentët të ketë drejtuar në skenë vepra sinfonike, ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë), vokalo sinfonike ose opera;
  - e) Për aktorët të kenë interpretuar në role kryesore në teatër ose në film;
  - f) Për regjisorët të kenë vendosur në skenë vepra teatrore, filmike, ose televizive;
  - g) Për skenografët/kostumografët të kenë vendosur në skenë shfaqje teatrore, televizive, operistike/balet ose në film artistik;
  - h) Për krijuesit e arteve pamore dhe të aplikuara të kenë hapur ekspozitë personale, vepra publike monumentale ose performancë artistike pamore, në arenën kombëtare;
  - i) Për koreografët/balerinët të kenë vënie në skenë në balet, të performancës në televizion ose teatër.

4. Kandidati nga secila prej fushave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni duhet të kenë marrë pjesë, së paku në 5 (pesë) realizime artistike si solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura në veprimtari (festivale, sezone, etj.) të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku, 2 (dy) nga veprat të jetë luajtur me trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike, regji apo role, në shfaqje/filma etj., ose veprimtari ekuivalente në artet pamore dhe të aplikuara) në një veprimtari ndërkombëtare, (festival, sezone).
5. Performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak dhe të jetë botuar në katalogët/agiendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse profesionale.
6. Për marrjen e titullit “Profesor i asociuar në arte”, kriteri për gradën shkencore “Doktor”, muk përbën detyrim.”
7. Personeli akademik me kohë të plotë që aplikon për titullin akademik “Profesor në Arte”, ekuivalent me “Profesor” duhet:
- të ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë artistike për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
  - të jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 8 (tetëvjeçare) akademike, ose me kohë të pjesshme, për një periudhë 12 (dymbëdhjetëvjeçare) akademike;
  - të jetë i aftë të mbajë leksione në një nga pesë gjuhët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian: angleze, frënge, gjermane, italiane, spanjolle, ose të mbrojë veprimtarinë artistike përpara Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik, në një nga gjuhët e mësipërme, në përputhje me statutin dhe rregulloren e UART.
8. Personeli akademik në fushën e arteve që aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor në Arte”, i njëvlershëm me titullin akademik “Profesor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij artistike, e cila reflektohet në realizimin e detyrimeve të mëposhtme:
- Për kompozitorët të kenë krijuar vepra të luajtura në skena që përfshijnë formën e sonatës ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë) ose vokalo sinfonike.
  - Për instrumentistët të kenë interpretuar vepër/a solistike në formën e sonatës ose ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë).
  - Për këngëtarët lirikë të kenë interpretuar në rol kryesor në opera;
  - Për dirigjentët të ketë drejtuar në skenë vepra sinfonike, ciklike (vepra me më shumë se 2 kohë), vokalo sinfonike ose opera;
  - Për aktorët të kenë interpretuar në role kryesore në teatër ose në film;
  - Për regjisorët të kenë vendosur në skenë vepra teatrale, filmike, ose televizive;
  - Për skenografët/kostumografët të kenë vendosur në skenë shfaqje teatrale, televizive, operistike/balet ose në film artistik;
  - Për krijuesit e arteve pamore dhe të aplikuara të kenë hapur ekspozitë personale, vepra publike monumentale ose performancë artistike pamore, në arenën kombëtare;
  - Për koreografët/balerinët të kenë vënie në skenë në balet, të performancës në televizion ose teatër.

9. Kandidati nga secila prej fushave të përcaktuara në pikën 8 të këtij neni duhet të ketë marrë pjesë, së paku në 7 (shtatë) realizime artistike si solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role të spikatura në veprimtari (festivale, sezone, etj.) të njohura kombëtare ose ndërkombëtare, ku së paku 3 (tre) nga veprat të jetë luajtur me trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike, regji apo role, në shfaqje/filma etj., ose veprimtari ekuivalente në artet pamore dhe të aplikuara) në veprimtari ndërkombëtare, (festival, sezone).

10. Performanca (vepra), sipas pikës 8, të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak dhe të jetë botuar në katalogët/agjendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse profesionale.

11. Personeli akademik, i cili ka titullin "Profesor i asociuar në Arte", aplikon për fitimin e titullit "Profesor në Arte", të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit "Profesor i asociuar në Arte".


12. Fitimi i titullit "Profesor i asociuar në Arte" dhe "Profesor në Arte" do të shoqërohet me efekte financiare sipas titullit akademik ekuivalent.


13. Veprimtaria e Komisionit të Përhershëm për Promovimin e Personelit Akademik rregullohet përmes rregullores së tij të brendshme, e cila miratohet nga Senati Akademik, në përputhje me aktet ligjore dhe nënljgore në fuqi.

2. Ky vendim t'i përcillet për miratim Senatit Akademik të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE


Laydrim SAHITAJ  
  
(Kryetar)

Jeton SHEHU  
  
(Anëtar)


Prof. Besnik Bisha

  
(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI

  
(Anëtar)

Ergis SEFA

  
(Anëtar)

Lorenc VANGJELI

  
(Anëtar)

Vladimir Llakaj

  
(Anëtar)